

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Fillo me një ide- Fito një intership në Bashkinë Tiranë”  
Thirrja V.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Projekte-  
22114311-5

**Vlera e Fondit Limit: 1.095.300 (një milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind) lekë pa  
tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe  
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit  
publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe  
miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me  
përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1*

d. *Lista e çmimeve të shërbimeve sipas Shtojcës 2*

*Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i  
vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”  
si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e  
Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë  
paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me  
përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me  
dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore  
pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose  
pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.  
Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare (2020, 2021) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, 55/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

*.... 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar". Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.*

**2.2.2** Kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (2020, 2021) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**2.2.3** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Operatori ekonomik i kualifikuar ne vend te pare duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit te shlyerjes se detyrimeve vendore per vitin 2022 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41/3, nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 9001:2015 (ose e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë ISO 14001:2015 (ose e përditësuar) mbi “Sistemet e menaxhimit ambjentit” në përputhje me objektin e prokurimit, ose i përditësuar (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zërave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

### **Argumentimi 2.3.2, 2.3.3**

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

... “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”*

ISO 9001:2015 (ose e përditësuar), parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

*ISO 14001 specifikon kërkesat e përgjithshme për vendosjen e një sistemi të menaxhimit mjedisor në një kompani. Ai përqendrohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke e mundur atë për të përmirësuar ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë. Një organizatë mund të marrë dhe zbatojë certifikimin ISO 14001, pavarësisht nga madhësia ose qëllimi i saj. Sistemet e menaxhimit të mjedisit bazuar në ISO 14001 ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një organizate me qëllim :*

- *Parandalimit të dëmtimit të mjedisit;*
- *Vlerësimit të aspekteve mjedisore;*
- *Përmirësimin e performancës mjedisore;*
- *Respektimin e ligjeve;*
- *Ruajtjen e burimeve natyrore dhe uljen e kostos;*
- *Përmirësimin e imazhit të kompanisë;*
- *Përmirësimin e komunikimit me figurat e autoritetit.*

**2.3.4.** Duke patur parasysh shërbimin e kërkuar për ofrimin e shërbimit të trajnimit/mentorimit, Operatori Ekonomik duhet të ketë një ekip të përbërë nga ekspertë dhe trajner, nga të cilët:

a. **1 (një) ekspert vlerësues dhe trajner ”Metodat e Kërkimit shkencor”**, me eksperiencë minimumi 2 (dy) vite në fushën e menaxhimit/kërkimit shkencor. Preferohet të ketë eksperiencë në trajnime lidhur me fushën e menaxhimit/kërkim shkencor. Të ketë aftësi drejtuese dhe aftësi

lehtësuese të punës në grup, të jetë i aftë të bashkëpunojë në grup; të ketë aftësi shumë të mira komunikimi.

Për të vërtetuar këtë, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë vijon:

1. Kontratë pune e vlefshme/ kontratë premtim angazhimi.
2. Diplomë (Të nivelit Msc) si dhe certifikime ose kualifikime në lidhje me fushën e tij.
3. Letër reference për realizimin e trajnimit në projekte të ngjashme të lëshuar nga subjekti përfitues.
4. CV.

**b. 1 (një) ekspert vlerësues dhe trajner "Planifikim dhe menaxhim projekti"** me eksperiencë minimumi 2 (dy) vite në fushën e menaxhimit. Preferohet të ketë eksperiencë në trajnime lidhur me fushën e menaxhimit/ menaxhim projekti. Të ketë aftësi drejtuese dhe aftësi lehtësuese të punës në grup, të jetë i aftë të bashkëpunojë në grup; të ketë aftësi shumë të mira komunikimi. Të jetë ekspert i fushës në planifikim dhe menaxhim të projekteve.

1. Kontratë pune e vlefshme/ kontratë premtim angazhimi.
2. Diplomë (Të nivelit Msc) dhe certifikime ose kualifikime në lidhje me fushën e tij.
3. Letër reference për realizimin e trajnimit në projekte të ngjashme të lëshuar nga subjekti përfitues.
4. CV.

Kriteri 2.3.4 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...]

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 41, pika 4.

*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duke qenë se projekti në vetëvete është i një rëndësie të vecantë, nisur nga specifikimet teknike dhe natyra e kontratës që do të prokurohet, kërkesa për staf të diplomuar/ certifikuar për të cilat kërkohet niveli i tyre profesional lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës.*

*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*Në kuadër të kësaj dsipozite ligjore AK ka kerkuar certifikatat e nevojshme dhe stafin e duhur per realizimin me sukses te sherbimit te projektit i cili eshte nje proces qe kerkon profesionalizem, eksperiencen e duhur per te konkluduar ne permbushjen me sukses te ketij sherbimi.*

**2.3.5.**Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) punonjës në muajin e fundit (duke marrë si referencë datën e hapjes së ofertave). Kjo të vërtetohet duke paraqitur vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore, ku specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.

*Kriteri 2.3.5 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Vendosija e këtij kriteri është në proporcion me natyrën e kontratës sepse realizimi i objektit të prokurimit kërkon nevojën për disponimin e punonjësve si më sipër cituar pasi projekti është një ndërthurje e zërave të mallit me ato të shërbimit sikundër janë procesi i

*dizenjimit dhe prodhimit të fletpalosjeve, dizenjimit dhe prodhimit të banerave roll up, posterave, certifikatave etj të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit (në kuadër të projektit) në sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë.*

*Për realizimin e objektit të kontratës kërkohet disponimi i një numëri optimal të punonjësve për të shmangur çdo lloj të metë në realizimin me sukses të projektit objekt prokurimi.*

**2.3.6.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës garanton se shërbimi i ofruar do të jetë në përputhje të plotë me specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e references.

**2.3.7** Operatori ekonomik për të vërtetuar që ka kapacitetet teknike për të ekzekutuar kontratën duhet të disponojë makineritë e mëposhtme:

- makineri me bojra ekologjike
- makineri uv me llakim

-Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin

fatura tatimore, zhdoganimin ose çdo lloj akti tjetër ligjor që vërteton pronësinë. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësit (fatura tatimore ose zhdoganimi ose çdo lloj akti tjetër ligjor që vërteton pronësinë qiradhënësit).

*Kriteri 2.3.7 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij **kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.**

*Referuar specifikimeve teknike dhe kërkesave të percaktuara nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e këtij objekti prokurimi dhe realizimin e proceseve të punës sa me sipër cituar lind e nevojshme edhe disponimi i makinerive të kërkuara duke qënë se vetë projekti është një ndërthurje e zërave të mallit me ato të shërbimit sikundër janë procesi i dizenjimit dhe prodhimit të fletpalosjeve, dizenjimit dhe prodhimit të banerave roll up, posterave, certifikatave të cilat duhet të prodhohen në cilësinë e duhur në mënyrë që të konkludohet në realizimin e tyre dhe në përfundimin e projektit me sukses.*

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**2.3.8.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë fizikisht ditën dhe orën e hapjes së ofertave mostra për zërat si më poshtë vijon:

*1. Filxhan mug, me logo projekti & bashkie e dizenuar 1(një) copë*

*2. Stilolapsa me logo projekti-1(një) copë*

*3. Dosje me log-1(një) copë*

*4. Bllok shënimesh me log-1(një) copë*

*5. USB 16gb-1(një) copë*

*6. Powerbank-1(një) copë*

*7. Çanta (Trasta) rrobë-1(një) copë*

*8. Mbajtëse çelsash-1(një) copë*

*9. Byzylykë llastiku-1(një) copë*

*10. T-shirt-1(një) copë*

*11. Postera-1(një) copë*

*12. Fletëpalosje-1(një) copë*

*13. Botime-1(një) copë*

*14. Certifikata-1(një) copë*

*Mosparaqitja e mostrës për artikujt objekt prokurimi është kusht s'kualifikues.*

**Argumentimi:**

*Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 40, pika 6, gërma a) ku cilësohet se:*

*“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor*

*përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces.*

*Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.*

*Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.*

*Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

***Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s’kualifikim.***

***Shënim:*** 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike janë si më poshtë vijon:

Projekti "Fillo me një ide – Fito një internship në Bashkinë Tiranë" Thirrja V është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr 143 datë 23.12.2022.

Qëllimi i këtij projekti është që të rinj në fillim të karrierës së tyre profesionale të fitojnë një eksperiencë pune në Bashkinë Tiranë, duke u ofruar mundësinë që të zhvillojnë aftësitë e tyre analitike dhe kërkimore përmes konkurimit me një koncept ide për projekt/ studim në një nga fushat e veprimtarisë së Bashkisë Tiranë. Të rinjtë do të kenë mundësi të përgatisin dhe të dorëzojnë një propozim të plotë teknik dhe financiar të projektit si dhe të përfundojnë studimin gjatë internshipit duke bashkëpunuar nga afër me stafin e Bashkisë për një periudhë 3 mujore praktike pune.

Projekti është i ndarë në disa faza dhe për realizimin e tyre kemi parashikuar:

### 1. Fushatë publicitare për promovimin e projektit:

- Baner Pull Up me logon e projektit dhe logon e BT me përmasa 0.85 m gjerësi dhe 2 metra gjatësi – 2 copë
- Postera me logon e projektit dhe logon e BT të formatit A3 – 15 copë
- Fletëpalosje me logon e projektit dhe logon e BT të formatit A5 – 200 copë

### 2. Organizimi i Konkursit:

- Pushime kafeje (kafe, çaj, ujë, biskota, kek) për 50 persona – 1
- Foni, 2 mikrofoa
- Qera salle – 1 ditë

### 3. Organizimi i Trajnimit 1 ditor - “Planifikim dhe Menaxhim Projekti” + 3 ditë mentorimi

- Katering – 20 persona - 1
- Pushime kafeje (kafe, çaj, ujë, biskota, kek) për 20 persona – 4

### 4. Organizimi i Trajnimit 1 ditor - “Metodat e Kërkimit Shkencor” + 3 ditë mentorimi

- *Katering – 20 persona - 1*
- *Pushime kafeje (kafe, çaj, ujë, biskota, kek) për 20 persona – 4*

5. *Materiale kancelarie për projektin dhe trajnimet:*

- *Stilolapsa me logo projekti, stilolaps me sustë, me mbajtëse dhe unazë metalike, me majën jo të hollë, ngjyra e bojës bojëqielli– 40 copë*
- *Bllok shënimesh me logo projekti, me përmasa 21 cm x 15 cm, të ketë minimalisht 75 fletë, me kapak dhe me spirale mbajtëse – 40 copë*
- *Dosje të thjeshta kartoni 300 gmr për përmasa të formatit A4 - 40 copë*
- *Filxhan mug me logon e projektit dhe logon e BT, filxhan – 30 copë*
- *Çanta (Trasta) rrobë me logo projekti dhe logon e BT – 30 copë*
- *USB 16 giga me logon e projektit – 30 copë*
- *Powerbank (karikues celulari portabël) me fuqi ngarkuese minimalisht 10.000 mAh – 30 copë*
- *Mbajtëse çelsash me logo me përmasa 4 x 2.5 cm - 30 copë*
- *Byzylykë llastiku me logo me përmasa 21 x 4 cm - 30 copë*
- *T-shirt me logo masat S,M,L,XL,XXL – 20 copë*

6. *Botime për projektin:*

- *Certifikata, Letër A4 300gr – 15 copë*
- *Botime Libër A4 (i formatuar) - 20 copë*

7. *Trajnime dhe module – Për më shumë specifikime shiko Aneksi 1*

- *Ekspert vlerësues dhe trajner “Metodat e Kërkimit Shkencor”*

- *Arsimimi:*
  - *Të ketë përfunduar studimet Msc.*
  - *Të ketë deri në 2 vite eksperiencë pune në fushën e kërkuar.*
  - *Të zotërojë certifikime ose kualifikime në lidhje me fushën e tij.*
  - *Preferohet të ketë eksperiencë në trajnime lidhur me kërkimin shkencor.*
  - *Të ketë aftësi drejtuese dhe aftësi lehtësuese të punës në grup, të jetë i aftë të bashkëpunoj në grup; të ketë aftësi shumë të mira komunikimi.*
- *Kohëzgjatja e kursit të trajnimit: 1 ditë trajnim dhe 3 ditë mentorim*
  - *Krijimi i të paktën 1 moduli të trajnimit*
  - *Pjesëmarrja në cilësinë e anëtarit në Komitete Vlerësuese*
- *Ekspert vlerësues dhe trajner “Planifikim dhe Menaxhim Projekti”*
  - *Arsimimi:*
    - *Të ketë përfunduar studimet Msc.*
    - *Të ketë deri në 2 vite eksperiencë pune në fushën e kërkuar.*
    - *Të zotërojë certifikime ose kualifikime në lidhje me fushën e tij.*
    - *Preferohet të ketë eksperiencë në trajnime lidhur me fushën e menaxhimit/ menaxhim projekti.*
    - *Të ketë aftësi drejtuese dhe aftësi lehtësuese të punës në grup, të jetë i aftë të bashkëpunoj në grup; të ketë aftësi shumë të mira komunikimi.*
  - *Kohëzgjatja e kursit të trajnimit: 1 ditë trajnim dhe 3 ditë mentorim*
    - *Krijimi i të paktën 1 moduli të trajnimit*
    - *Pjesëmarrja në cilësinë e anëtarit në Komitete Vlerësuese*

### Aneksi 1

#### (1) SPECIFIKIME PËR EKSPERT VLERËSUES DHE TRAJNER Planifikim dhe Menaxhim Projekti

*Projekti “Fillo me një ide - Fito një internship në Bashkinë Tiranë” dhe Udhëzuesi Operacional, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 143 datë 23.12.2023*

*Krijim moduli dhe materialesh trajnim, ofrim dhe vlerësim i trajnimit “Planifikim dhe Menaxhim Projekti”, pjesëmarrje në cilësinë e anëtarit në Komitete Vlerësuese*

- A. *Pozicion: Ekspert vlerësues dhe trajner “Planifikim dhe Menaxhim Projekti”*
- B. *Vendndodhja: Tiranë*
- C. *Referenca e Projektit: Projekti “Fillo me një ide- Fito një internship në Bashkinë Tiranë” dhe Udhëzuesi Operacional, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 143 datë 23.12.2023*
- D. *Kohëzgjatja: - Projekti do të kryhet për një periudhë kohore prej 6 (gjashtë) muajsh nga data e lidhjes së kontratës.*
- E. *Përshkrim i shkurtër i projektit: Bashkia Tiranë po implementon projektin “Fillo me një ide- Fito një internship në Bashkinë Tiranë” Thirrja V. Qëllimi i këtij projekti është që të rinj në fillim të karrierës së tyre profesionale të fitojnë një eksperiencë pune në Bashkinë Tiranë, duke u ofruar mundësinë që të zhvillojnë aftësitë e tyre analitike dhe kërkimore përmes konkurrimit me një koncept ide për projekt ose studim në një nga fushat e veprimtarisë së Bashkisë Tiranë. Të rinjtë do të kenë mundësi të përgatisin dhe të dorëzojnë një propozim të plotë teknik dhe financiar të projektit si dhe të përfundojnë studimin gjatë internshipit duke bashkëpunuar nga afër me stafin e Bashkisë për një periudhë 3 mujore praktike pune. Ky projekt u mundëson 15 të rinjve dhe të rejave të grupmoshës deri në 28 vjeç të zhvillojnë praktikë pune dhe të fitojnë një çmim gjatë një angazhimi 3 mujor pranë Bashkisë Tiranë duke dorëzuar në fund të këtij angazhimi propozimet e plota për projekt dhe studimet e plota. Të gjitha propozimet (koncept-ide për projekt/studim) do të vlerësohen nga një Komitet Vlerësues i ngritur në nivel njësie organizative. Rezultatet e konkurrimit do të shpallen gjatë një aktiviteti publik të organizuar nga Bashkia Tiranë. Trajnimet mbi “Planifikim dhe Menaxhim Projekti” dhe “Kërkim shkencor” janë pjesë e veprimtarisë formuese të studentëve (15 të rinj), të cilët do të shpallen fitues në këtë projekt.*
- F. ***Kriteret për përzgjedhjen e ofertave duhet të bazohen në këto të dhëna (specifikimet teknike të mallit/shërbimit/punës):***
  - *Niveli i kursit të trajnimit: fillestar*
  - *Kohëzgjatja e kursit të trajnimit: 1 ditë*

- Numri maksimal i pjesëmarrësve: 20 persona
- Gjuha e trajnimit: shqip
- Curriculum-Vitae të Ekspertit Vlerësues dhe Trajner
- Objektivat e trajnimit: Pas trajnimit pjesëmarrësit duhet të jenë të aftë të kuptojnë bazat e menaxhimit të projektit: të fillojnë, si të planifikojnë dhe si të zbatojnë një projekt që arrin qëllimin dhe objektivat e përcaktuara.
- Plani i trajnimit: titulli i trajnimit; përshkrim i trajnimit; objektivat e të mësuarit; temat e trajnimit (outline); kohëzgjatja e trajnimit; pjesëmarrësit; materialet e trajnimit (slidet); logjistika e trajnimit
- Numri i moduleve të trajnimit: jo më pak se 1 modul trajnimi.
- Tema e modulit të trajnimit: tema e modulit të trajnimit duhet të adresojë arritjen e objektiveve të trajnimit.
- Objektivat e ekspertit vlerësues: pjesëmarrje në Komitete Vlerësuese dhe ofrimi i ekspertizës në vlerësimin e koncept- ideve për projekt/studim duke siguruar prezencën në çdo takim pune të anëtarëve të Komitetit Vlerësues dhe duke siguruar ushtrimin e detyrave bazuar në parimin e ruajtjes së konfidencialitetit dhe shmangies së konfliktit të interesit; hartimi dhe nënshkrimi i formularëve individual për vlerësimin sipas kriterëve të çdo koncept ideje për projekt/studim dhe përgatitja e tabelës përmbledhëse të vlerësimit.

**G. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**

- a) Krijimi i të paktën 1 moduli trajnimi
- b) Ofrimi i një trajnimi 1 ditor “Planifikim dhe Menaxhim Projekti” dhe 3 ditëve mentorim
- c) Pjesëmarrja në cilësinë e anëtarit në Komitete Vlerësuese

## (2) SPECIFIKIME PËR EKSPERT VLERËSUES DHE TRAJNER

### Kërkim shkencor

*Projekti “Fillo me një ide- Fito një internship në Bashkinë Tiranë” dhe Udhëzuesi Operacional, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 143 datë 23.12.2023*

*Krijim moduli dhe materialesh trajnim, ofrim dhe vlerësim i trajnimit “Metodat e Kërkimit Shkencor”, pjesëmarrje në cilësinë e anëtarit në Komitete Vlerësuese*

A. Pozicion: Ekspert vlerësues dhe trajner” Kërkim shkencor”

B. Vendndodhja: Tiranë

C. Referenca e Projektit: Projekti “Fillo me një ide- Fito një internship në Bashkinë Tiranë” dhe Udhëzuesi Operacional, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 143 datë 23.12.2023

D. Kohëzgjatja: Projekti do të kryhet për një periudhë kohore prej 6 (gjashtë) muajsh nga data e lidhjes së kontratës.

E. Përshkrim i shkurtër i projektit: Bashkia Tiranë po implementon projektin “Fillo me një ide- Fito një internship në Bashkinë Tiranë” Thirrja V. Qëllimi i këtij projekti është që të rinj në fillim të karrierës së tyre profesionale të fitojnë një eksperiencë pune në Bashkinë Tiranë, duke u ofruar mundësinë që të zhvillojnë aftësitë e tyre analitike dhe kërkimore përmes konkurrimit me një koncept ide për projekt ose studim në një nga fushat e veprimtarisë së Bashkisë Tiranë. Të rinjtë do të kenë mundësi të përgatisin dhe të dorëzojnë një propozim të plotë teknik dhe financiar të projektit si dhe të përfundojnë studimin gjatë internshipit duke bashkëpunuar nga afër me stafin e Bashkisë për një periudhë 3 muajsh praktike pune. Ky projekt u mundëson 15 të rinjve dhe të rejave të grupmoshës deri në 28 vjeç të zhvillojnë praktikë pune dhe të fitojnë një çmim gjatë një angazhimi 3 muajsh pranë Bashkisë Tiranë duke dorëzuar në fund të këtij angazhimi propozimet e plota për projekt dhe studimet e plota. Të gjitha propozimet (koncept-ide për projekt/studim) do të vlerësohen nga një Komitet Vlerësues i ngritur në nivel njësie organizative. Rezultatet e konkurrimit do të shpallen gjatë një aktiviteti publik të organizuar nga Bashkia Tiranë. Trajnimet mbi “Planifikim dhe Menaxhim Projekti” dhe “Kërkim shkencor” janë pjesë e veprimtarisë formuese të studentëve (15 të rinj), të cilët do të shpallen fitues në këtë projekt.

**F. Kriteret për përzgjedhjen e ofertave duhet të bazohen në këto të dhëna (specifikimet teknike të mallit/shërbimit/punës):**

- Niveli i kursit të trajnimit: fillestar
- Kohëzgjatja e kursit të trajnimit: 1 ditë trajnim dhe 3 ditë mentorim
- Numri maksimal i pjesëmarrësve: 20 persona
- Gjuha e trajnimit: shqip
- Curriculum-Vitae të Ekspertit Vlerësues dhe Trajner

- *Objektivat e trajnimit: Pas trajnimit pjesëmarrësit duhet të jenë të aftë të artikulojnë qartësisht një pyetje kërkimi /studimi ose një problem dhe të formulojnë hipoteza; të identifikojnë metodologji të ndryshme kërkimi/studimi; të njohin koncepte bazë të fushës së kërkimit shkencor; të përdorin aftësi në zgjidhjen e problemeve; të reflektojnë mbi kërkimin e tyre , duke parë mundësi për përmirësim, pikat e forta dhe të dobta ; të artikulojnë rëndësinë e punës së tyre dhe ta prezantojnë atë tek palët e interesuara;*
- *Plani i trajnimit: titulli i trajnimit; përshkrim i trajnimit; objektivat e të mësuarit; temat e trajnimit (outline); kohëzgjatja e trajnimit; pjesëmarrësit; materialet e trajnimit (slidet); logjistika e trajnimit*
- *Numri i moduleve të trajnimit: jo më pak se 1 modul trajnimi*
- *Tema e modulit të trajnimit: tema e modulit të trajnimit duhet të adresojnë arritjen e objektivave të trajnimit.*
- *Objektivat e ekspertit vlerësues: pjesëmarrje në Komitete Vlerësuese dhe ofrimi i ekspertizës në vlerësimin e koncept- ideve për projekt/studim duke siguruar prezencën në çdo takim pune të anëtarëve të Komitetit Vlerësues dhe duke siguruar ushtrimin e detyrave bazuar në parimin e ruajtjes së konfidencialitetit dhe shmangies së konfliktit të interesit; hartimi dhe nënshkrimi i formularëve individual për vlerësimin sipas kriterëve të çdo koncept ideje për projekt/studim dhe përgatitja e tabelës përmbledhëse të vlerësimit.*

#### *G. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:*

- Krijimi i së paku 1 moduli trajnimi*
  - Ofrimi i një trajnimi 1 ditor “Metodat e Kërkimit Shkencor” dhe 3 ditë mentorim*
  - Pjesëmarrja në cilësinë e anëtarit në Komitete Vlerësuese.*
- **Stilolapsa me logo projekti, stilolaps me sustë, me mbajtëse dhe unazë metalike, me majën jo të hollë, ngjyra e bojës bojëqielli** – Një model standart i përshtatshëm edhe estetikisht për shfaqjen e logimit.
  - **Bllok shënimesh me logo projekti, me përmasa 21 cm x 15 cm, të ketë minimalisht 75 fletë, me kapak dhe me spirale mbajtëse** – Referuar përmasave standarte të një blloku shënimesh, i mjaftueshëm për tu përdorur gjatë periudhës 3 mujore të internshipit dhe praktik për tu mbajtur si në çanta/ trasta dhe dosje projekti.
  - **Dosje të thjeshta kartoni 300 gmr për përmasa të formatit A4 me logo projekti** – Dosjet të përshtatshme për të mbajtur materialet (fleta A4, blloku + mjete kancelarie) që do të nevojiten për zhvillimin e studimeve/ projekteve dhe trajnimeve.
  - **Çanta (Trasta) rrobë me logo projekti** - Trasta praktike dhe ekologjike, të përshtatshme për të mbajtur materialet (fleta A4, blloku + mjete kancelarie) që do të nevojiten për zhvillimin e studimeve/ projekteve dhe trajnimeve.

- **Filxhan mug me logon e projektit** – Filxhan mug i përshtashëm i përmasave standarte, për promovimin e projektit.
- **Mbajtëse çelsash me logo me përmasa 4 x 2.5 cm** - Përmasat standarte të mbajtëses të çelsave referuar përmasave të logos të projektit me qëllim pasqyrimin estetik të saj.
- **Byzlykë llastiku me logo me përmasa 21 x 4** - Përmasat standarte të byzlykëve referuar përmasave të logos të projektit me qëllim pasqyrimin estetik të saj.
- **T-shirt me logo masat S,M,L,XL,XXL** – T-shirt do të jenë në përmasat e ndryshme me qëllim përshtatjen me aplikantët fitues.
- **Postera me logon e projektit dhe logon e BT të formatit A3** - Poster i përmasave standart me qëllim pasqyrimin estetik të materialit të nevojshëm për promovimin e projektit.
- **Fletëpalosje me logon e projektit dhe logon e BT të formatit A5** - Fletëpalosjet duhen në formatin A5, me qëllim shpërndarjen e tyre gjatë fazës së promovimit të projektit (takime, panairë) me qëllim pasqyrimin estetik të materialit të nevojshëm për promovimin e projektit.
- **USB 16 giga me logon e projektit** – USB 16 giga-byte, një madhësi mesatare, me hapësirë të mjaftueshme për ngarkimin e materialeve (nga trajnimet, studimi/ projekti) që do të përdoren gjatë projektit.
- **Powerbank (karikues celulari portabël) me fuqi ngarkuese minimalisht 10.000 mAh** - Karikuesi portabël duhet me fuqi 10.000 mAh, një fuqi mesatare për përdorim nga të rinjtë, me qëllim promovimin e projektit.
- **Certifikata, letër format A4 me peshe 300 gr, ngjyrë pana e lehtë e dizenuar sipas kërkesës së autoritetit kontraktor në momentin e finalizimit të projektit** - Është modeli standard dhe më i përdorur për projekte.
- **Botime libër, format A4, i formatuar dhe dizenuar sipas kërkesës së autoritetit kontraktor në momentin e finalizimit të projektit** - Është modeli standard dhe i përshtashëm për pasqyrimin e duhur të punimeve të të rinjve.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Fillo me një ide- Fito një intership në Bashkinë Tiranë” Thirrja V**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

#### **Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

- Dokumentat e tenderit
- Termat e referencës/ specifikimet teknike